



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MEMALIAJ

Nr prot

Memaliaj me / /2026

RELACION

Lenda : Riveshje pjesore dhe mbushja e gropave në rrugët rurale te fshatrave

Toc Krahes I poshtem – Kalivac

Bazuar ne kerkesat e ardhura nga banoret e fshatrave per amortizimin e rrugeve dhe problematikave qe ju sjell gjendja aktuale e tyre Kryetari i Bashkise nxorri urdherin Nr 151 , date 12.06.2026, protokolluar me nr 1649/2 prot , date 12.06.2026 per “Ngritjen e grupit te punes per verifikimin e gjendjes se segmenteve rrugore ne Njesite Administrative Krahes dhe Qesarat”

Grupi i punes beri inspektimin në terren dhe konstatoi gropa, çarje, shkëputje të shtresës bituminoze, deformime lokale dhe konsumim i shtresës së sipërme në disa pjesë të trasesë. Për evidentimin e problematikës janë kryer matjet në terren dhe është realizuar dokumentimi fotografik i të gjitha zonave të dëmtuara, mbi bazën e të cilave është hartuar preventivi përkatës i ndërhyrjes.Ndërhyrja konsiderohet e nevojshme për përmirësimin e kushteve të qarkullimit, rritjen e sigurisë së përdoruesve, parandalimin e përhapjes së mëtejshme të dëmtimeve, zgjatjen e jetëgjatësisë së shtresës rrugore ekzistuese dhe uljen e kostove të mirëmbajtjes në të ardhmen.

1. Rruga rurale fshati Toc, njesia administrative Qesarat është ndërtuar ne vitin 2017 me shtresë veshëse prej rëre bituminoze. Si pasojë e përdorimit të vazhdueshëm, veprimit të faktorëve atmosferikë, depërtimit të ujërave sipërfaqësore dhe mungesës së ndërhyrjeve periodike të mirëmbajtjes, në segmente të ndryshme të saj janë krijuar dëmtime të konsiderueshme.

Punimet që do të kryhen :

Fillimisht do behet pastrimi i pjeseve te demtuara ,shperndarja e prajmerit , pastaj shperndarja e reres bituminoze me makineri dhe ngjeshja me rul

Gjatesia e segmentit qe do te rivishet me rere bituminoze eshte 562 ml dhe gjeresia 3m, gjithsej

1686 m2, t=10cm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kjo rrugë ka dhe dy kthesa me shtrese betoni, në këto dy kthesa do të skarifikohet shtresa e demtuar, largimi i mbeturinave dhe në fund shtresa e betonit.

Gjatesia që do të shtrohet me beton është 165 m, gjerësia 3m, gjithsej 495 m², t= 5 cm dhe C16/20

2. Rruga rurale fshati Krahes I poshtem, njësia administrative Krahes është shtruar në vitin 2006 ,rruga është e shtruar me asfaltobeton, në segmente të ndryshme të saj janë krijuar dëmtime të konsiderueshme që e vështirojnë lëvizjen e automjeteve. Gjatesia e segmenteve të demtuara është 410 m, gjerësia 3m , t= 5cm.

Punimet që do të kryhen:

Prerje asfalti me disk, skarifikim i shtresës së demtuar, largimi i materialeve me auto, shpërndarja e prajmerit, në fund shtresa e asfaltobetonit me makineri dhe ngjeshja me rul.

3. Rruga rurale fshat Kalivac njësia administrative Krahes është shtruar në vitin 2005 me asfaltobeton. Nga verifikimi në vend për shkak të përdorimit të vazhdueshëm edhe të mjeteve të rënda , veprimi i faktoreve atmosferike dhe mungesa e mirëmbajtjes ka sjellë shkeputje të shtresës, deformime lokale dhe konsumim të shtresës së sipërme.

Gjatesia 124 m. gjerësia 3.5 m, gjithsej 434 m², t= 5cm

Punimet që do të kryhen::

Prerje asfalti me disk, skarifikim i shtresës së demtuar, largimi i materialeve me auto, shpërndarja e prajmerit, në fund shtresa e asfaltobetonit me makineri dhe ngjeshja me rul.

Bashkangjitur relacionit janë fotot , kilometrazhi dhe preventivat përkatëse.

- ❖ Nga verifikimet në terren rezulton se dëmtimet e konstatuara kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme përmes mbushjes së gropave dhe riveshjes pjesore. Realizimi i këtyre punimeve do të sigurojë rikthimin e parametrevë normalë të shfrytëzimit të rrugës dhe përmirësimin e kushteve të qarkullimit.

KRYETAR

ALBERT MALAJ

Konceptoi P.Hoxha

Pranoi L.Mici



REPUBLIKA E SHQIPËRISË